



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për **1 (një)** pozicion pune, personel akademik, me kohë të plotë me afat të përcaktuar, të kategorisë *asistent lektor*, deri më datë 30.09.2022.

Kriteret e kandidatit të kategorisë **1 (një)** *asistent lektor* janë si më poshtë:

Kandidati duhet të zotërojë këto kriteret të përgjithshme e të veçanta:

- Të ketë përfunduar studimet universitare, Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, në fushën e Shkencave Fizike, në profilin fizikë e aplikuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njëzuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
- Të ketë përfunduar studimet Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, në profilin fizikë e aplikuar me notë mesatare mbi 8.
- Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
- Preferohet të ketë publikime, trajnime si edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore të lidhura me profilin.
- Të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë në mësimdhënie në IAL.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**21.02.2022– 02.03.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njëzuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njëzuar me origjinalin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (21.02.2022– 02.03.2022) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Aplikim për pozicionin e punës:
Asistent lektor – Departamenti i Fizikës
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit të Shkencave të Natyrës**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (04.03.2022– 15.03.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

Shënim: *Formularët për plotësim gjenden në adresën:*

www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion